



REPUBLIKAE SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKT LIGJ
PËR QEVERISJEN ELEKTRONIKE

Nr. _____ datë _____ 2017

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e autoriteteve publike në lidhje me krijimin, zhvillimin dhe menaxhimin e sistemeve të infrastrukturës shtetërore të informacionit, përcaktimin e rregullave për ngritjen dhe ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike në Republikën e Shqipërisë si dhe aksesin e informacionit në rrugë elektronike.

Neni 2
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton:

- a) Parimet e përgjithshme të qeverisjes elektronike dhe infrastrukturës së saj;
- b) Detyrimet e autoriteteve publike në ofrimin e shërbimeve në mënyrë elektronike si dhe mënyrat e ofrimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike;
- c) Të drejtat e personave fizikë dhe juridikë për të komunikuar me autoritetet publike përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
- d) Funksonimin dhe ndërveprimin e autoriteteve përgjegjëse për qeverisjen elektronike;
- e) Infrastrukturën e shërbimeve të qeverisjes elektronike;
- f) Sistemin e Administrimit dhe Protokollit të Dokumentit Elektronik Për Institucionet e Administratës Shtetërore në nivel Qendror.

Neni 3

Fusha e veprimit

1. Ky ligj zbatohet nga autoritetet publike që në ushtrimin e kompetencave të tyre në ofrimin e shërbimeve publike në rrugë elektronike përmes përdorimit të sistemeve dhe rrjeteve të informacionit dhe komunikimit.
2. Ky ligj zbatohet edhe në rast se një pjesë e procedurave të ndjekura për ofrimin e shërbimit, apo veprimit të komunikimit, apo ndërveprimit, kryhet me mjete jo elektronike, përveç rasteve kur në ligj parashikohet se procedura e ofrimit të shërbimit bëhet vetëm në formë joelektronike.
3. Ky ligj nuk zbatohet në rastin e dokumenteve elektronike që përmbajnë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Autoritet publik” ka të njëjtin kuptim me atë në Ligjin “Për të drejtën e informimit”;

“Autentifikimi” është një proces elektronik që mundëson identifikimin elektronik të sigurt të një personi fizik ose juridik apo konfirmimin e origjinës dhe integritetin e të dhënave në formë elektronike.

“Administrimi i dokumentit elektronik në nivel qendror (EDMS)” është sistemi i informacionit që i shërben qarkullimit, protokollimit, organizimit, klasifikimit dhe arkivimit të dokumenteve administrative që krijohen nga nëpunësit e administratës publike, personat fizike dhe/ose juridike, nëpërmjet përdorimit të sistemeve të informacionit/ teknologjive të informacionit dhe komunikimit;

“Administrimi i Protokollit elektronik (ERM)” është sistemi i informacionit që i shërben grumbullimit, regjistrimit dhe shpërndarjes së dokumenteve që qarkullojnë me çfarëdo lloj mënyre që prodhohen;

“Aplikues” është çdo individ që aplikon elektronikisht, në portalin unik qeveritar apo në portalin e çdo institucioni që ofron shërbimin, për të përfituar një shërbim elektronik publik;

“Dokumenta administrative” janë të gjitha dokumentet e gjeneruar nëpërmjet përfitimit të shërbimit elektronik publik, me kërkesë të aplikuesit nëpërmjet portaleve qeveritare;

“Dokument elektronik” ka të njëjtin kuptim me atë në Ligjin “Për dokumentin elektronik”;

“Informacion publik” ka të njëjtin kuptim me atë në Ligjin “Për të drejtën e informimit”.

“Infrastruktura e ofrimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike” është tërësia e pajisjeve fizike, programeve dhe infrastruktura fizike e ndërlidhur që mundëson ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike;

“Identifikim elektronik i sigurt” është procesi i identifikimit elektronik të një personi fizik dhe verifikimi i vërtetësisë së identitetit të tij, nëpërmjet përdorimit të të dhënave të identitetit personal në formë elektronike, të cilat përfaqësojnë në mënyrë unike personin fizik apo juridik, ose personin fizik që përfaqëson personin juridik;

“Ministër” – është ministri përgjegjës për shoqërinë e informacionit dhe TIK;

“Nënshkrimi elektronik” ka të njëjtin kuptim me atë në Ligjin “Për nënshkrimin elektronik”;

“Ofrimi i shërbimeve të qeverisjes elektronike” është kombinimi i veprimtarive teknike dhe organizative të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike;

“Platforma Qeveritare e Ndërveprimit” është ndërfaqja që mundëson ose menaxhon komunikimin midis bazave të të dhënave shtetërore me qëllim ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike;

“Përdorues”/marrës i shërbimit” është personi fizik ose juridik që përdor shërbimet e qeverisjes elektronike, duke përfshirë nëpunësit e autoriteteve publike, që përdorin shërbime të qeverisjes elektronike në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tyre;

“Përfitim i shërbimit elektronik publik” janë të gjitha të dhënat që merren nga transmetimi elektronik i sigurt, dhe që formatohen në një dokument administrativ i gjeneruar nga sistemi elektronik;

“Portali unik qeveritar www.e-albania.al” është zyrë me një ndalesë për shërbimet online të administratës publike;

“Regjistri Kombëtar i shërbimeve elektronike qeveritare” është regjistri që mbahet në përputhje me ligjin “Për bazat e të dhënave shtetërore”

“Siguria e sistemeve të informacionit” është tërësia e masave, politikave, procedurave, teknologjia dhe masat të nevojshme për mbrojtjen e të dhënave/elementeve të sistemit të informacionit, por edhe tërë sistemit, nga çdo kërcënim i qëllimshëm apo i rastësishëm;

“Shërbim i qeverisjes elektronike” është shërbim publik i cili ofrohet nga autoritetet publike për personat fizikë dhe juridikë të interesuar ose ndërmjet vetë autoriteteve publike përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në tipologjinë G2C, G2B, G2G;

“Vërtetimi” është procesi elektronik i përcaktimit dhe vlerësimit të identitetit të një personi fizik që përdor një shërbim të qeverisjes elektronike;

“Vula elektronike” ka të njëjtin kuptim me atë të ligjit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara;

“Regjistrim” është procedura që konsiston në deklarimin e vullnetit, për përdorimin e shërbimeve elektronike, dorëzimin e dokumenteve plotësues dhe atyre legjitime dhe vërtetimit të identifikimit;

“TIK” është teknologjia e informacionit dhe komunikimit;

“Transmetimi elektronik” ka të njëjtin kuptim me atë në Ligjin “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”;

KREU II

PARIME TË PËRGJITHSHME TË QEVERISJES ELEKTRONIKE

Neni 5

Parime të përgjithshme

1. Ofrimi i shërbimeve të qeverisjes elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë nga autoritetet publike, sipas këtij ligji, kryhen në bazë të parimeve të ligjshmërisë, mosdiskriminimit, objektivitetit, transparencës dhe proporcionalitetit.
2. Parimet e sipërpërmendura kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 6

Parimi i ndarjes së kompetencave

1. Ndarja e kompetencave, caktimi i funksioneve dhe detyrave administrative midis autoriteteve publike që ofrojnë shërbime të qeverisjes elektronike dhe autoriteteve përgjegjëse për ofrimin e shërbimit duhet të jenë të qarta dhe të mirëpërcaktuara, specifike, të shmangin mbivendosjen, të jenë transparente dhe të bëhen publike në mënyrë të përshtatshme.
2. Në rregullimin dhe organizimin e shërbimit të qeverisjes elektronike sigurohet identifikimi i qartë i përgjegjshmërisë për vonesat dhe joefikasitetin në ofrimin e tyre.

Neni 7
Parimi i informimit

1. Autoritetet përgjegjëse u ofrojnë autoriteteve publike dhe/ose personave fizikë dhe juridikë që kërkojnë shërbim të qeverisjes elektronike të gjithë informacionin e nevojshëm në mënyrë elektronike, në përputhje me parashikimet e legjislacionit që rregullon të drejtën e informimit.
2. Autoritetet publike, kujdesen për mënyrën e informimit, komunikimit dhe të shërbimeve të qeverisjes elektronike në mënyrë të tillë që ato të jenë lehtësisht të përdorshme.
3. Kostoja, përcaktimi i saj dhe vendosja e tarifave për informacionin e kërkuar në mënyrë elektronike rregullohen sipas parashikimeve të legjislacionit për të drejtën e informimit.
4. Refuzimi i dhënies së informacionit, sipas këtij neni, do të bëhet kryesisht, në përputhje me kufizimet e parashikuara nga legjislacioni për të drejtën e informimit ose edhe kufizime të tjera të parashikuara në ligje të veçanta.

Neni 8
Parimi i barazisë dhe aksesit

1. Autoritetet publike në bazë të këtij ligji ofrojnë për të gjithë personat fizikë dhe juridikë akses në shërbimet e qeverisjes elektronike në mënyrë të barabartë, jodiskriminuese, objektive dhe transparente. Në çdo rast duhet të respektohen kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi.
2. Një trajtim i ndryshëm i personave në ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike lejohet vetëm mbi bazën e dallimeve objektive dhe shkaqeve të justifikuara, sipas legjislacionit që rregullon fushën e mosdiskriminimit.
3. Autoritetet publike janë të detyruar që t'u ofrojnë akses personave, brenda kufijve të kërkesës së paraqitur dhe nivelit të aksesit të lejuar, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sekretin shtetëror, në regjistrat publikë dhe bazat e të dhënave shtetërore, me qëllim përfitimin e shërbimit të kërkuar.
4. Autoritetet publike, brenda mundësive financiare, kompetencës së tyre dhe duke zbatuar rregullat për ruajtjen e të dhënave personale, në ofrimin e shërbimeve publike përpiqen të zbatojnë zgjidhjet inovative dhe teknologjike, të cilat mundësojnë një akses më të madh të personave në shërbimet e qeverisjes elektronike.

Neni 9
Parimi i eficiencës dhe i cilësisë

1. Organizimi i ofrimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike duhet të sigurojë efikasitet në kryerjen e funksioneve e të detyrave, si dhe eficiencën e procesit, me qëllim ofrimin e shërbimeve publike me cilësi më të lartë dhe me kosto sa më të ulët.
2. Procedura administrative e ofrimit të shërbimeve zhvillohet, në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin që rregullon shërbimin specifik.
3. Autoritetet publike marrin masa për zhvillimin sistematik të infrastrukturës së shërbimeve të qeverisjes elektronike me qëllim rritjen e eficiencës së ofrimit të shërbimeve.

Neni 10
Parimi i bashkëpunimit

Autoritetet publike që ofrojnë shërbimet e qeverisjes elektronike dhe autoritetet përgjegjës për realizimin e shërbimit, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Neni 11

Parimi i garantimit të sigurisë dhe integritetit

1. Autoritetet publike përdorin TIK, shërbimet dhe/ose aplikacionet e qeverisjes elektronike në përputhje me rregullat dhe parimet e këtij ligji, duke u kujdesur për sigurinë, integritetin dhe disponibilitetin e sistemeve, shërbimeve të qeverisjes elektronike dhe të aksesit në to.
2. Autoritetet publike kujdesen për sigurinë, origjinalitetin, vërtetësinë e të dhënave dhe të informacionit që krijojnë, regjistrojnë, ruajnë apo që administrojnë në çdo mënyrë tjetër shërbimet e qeverisjes elektronike që ofrojnë gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre.
3. Rregullimet e këtij ligji për sigurinë dhe integritetin nuk anashkalojnë detyrimet e autoritetit publik në rastet e trajtuara sipas legjislacionit për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

Neni 12

Parimi i ofrimit vetëm një herë

Ofrimi i shërbimeve të qeverisjes elektronike bëhet mbi bazën e parimit “vetëm një herë”. Autoriteti përgjegjës për realizimin e shërbimit siguron që dokumentat e kërkuara nga qytetari apo biznesi të paraqiten vetëm një herë sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 13

Parimi për open source/burimet e hapura

Autoritetet publike që ofrojnë shërbimet e qeverisjes elektronike dhe autoritetet përgjegjës për realizimin e shërbimit, udhëhiqen nga parimi për të zbatuar/aplikuar “open source”/“burimet e hapura” sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 14

Parimet e ndërtimit të infrastrukturës së qeverisjes elektronike

Zhvillimi i infrastrukturës së qeverisjes elektronike duhet të sigurojë:

- a) Disponueshmërinë e të dhënave nga regjistrat publike të gjithë autoriteteve të sektorit publik për qytetarët dhe përfituesit e tjerë në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, konfidencialitetin e të dhënave, sigurinë e sistemeve të informacionit, rregullat për lirinë e informacionit;
- b) Zhvillimin sistematik të vazhdueshëm të infrastrukturës qendrore të qeverisjes elektronike;
- c) Mbrojtje sistematike të vazhdueshme dhe sigurinë e infrastrukturës së qeverisjes elektronike në përputhje me rregullat mbi sigurinë përfshirë garantimin e vazhdueshmërisë së biznesit (BCC) dhe përballimin e fatkeqësive (DRC);
- d) Zhvillimet e infrastrukturës së qeverisjes elektronike mbi bazën e nevojave dhe prioriteteve të harmonizuara;
- e) Rregullimi/harmonizimi i planeve dhe projekteve të kompjuterizimit me standardet dhe udhëzimet e ndërtimit të infrastrukturës së qeverisjes elektronike me praktikën e komunitetit evropian;
- f) Ndërveprimin e sistemeve, përfshirë mundësimin e ndërveprimit për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare sipas praktikave të komunitetit evropian;
- g) Racionalizimin e shpenzimeve dhe reduktimin e kostove për ndërtimin e infrastrukturës, zhvillimin e përshkallëzuar sipas nevojës dhe ripërdorimin duke shmangur dublikimin e infrastrukturave.

- gj) Garantimin e qëndrueshmërisë së investimeve me ndryshimet teknologjike dhe zhvillimin e kërkesave;

KREU III

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE NË FUSHËN E QEVERISJES ELEKTRONIKE

Neni 15

Detyrimet e autoriteteve publike për të informuar në formë elektronike

1. Autoriteti publik përgjegjës për ofrimin/realizimin e shërbimit elektronik është i detyruar të ofrojë në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, lehtësisht të aksesueshme për përdoruesit informacion mbi:
 - a) emrin e autoritetit publik/ofruesit të shërbimit dhe, nëse nuk ka të tillë, emrin me anë të të cilit ai është regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë;
 - b) adresën e vendit, në të cilën është vendosur selia apo qendra kryesore e veprimtarisë së ofruesit të shërbimit;
 - c) adresën e postës elektronike apo çdo detaj tjetër që lejon komunikimin e shpejtë dhe efikas me ofruesin e shërbimit ku përdoruesi mund të marrë informacion në lidhje me shërbimet, këshilla dhe ndihmë për veprimet e nevojshme që duhet të ndërmerren për të marrë shërbimin;
 - d) informacion në lidhje me organin/autoritetin që ushtron kontroll mbi funksionimin e saj;
 - e) informacion për shërbimet e ofruara sipas modeleve të miratuara për shërbimet publike;
 - f) informacione të tjera të parashikuara me ligj.
2. Kushtet e përdorimit dhe kufizimet e informacionit të publikuar dhe shërbimeve të ofruara në faqet zyrtare të internetit të autoriteteve publike, duhet të jenë të dukshme dhe të pasqyruara qartë. Ndryshimet në kushtet e përdorimit dhe kufizimeve duhet të publikohen menjëherë dhe të jenë lehtësisht të identifikueshme në faqen zyrtare në internet.
3. Për aq sa me ligj nuk parashikohet ndryshe, informacioni që publikohet në faqet zyrtare të internetit, të autoriteteve publike, është i lirë të shkarkohet/transferohet, ruhet, përpunohet, shpërndahet dhe përdoret, me kusht që të tregohet në mënyrë të qartë burimi i tyre, dhe të mos paraqiten si informacione origjinale nëse kanë pësuar ndryshime.

Neni 16

Detyrimi për mbrojtjen e të dhënave personale

Autoritetet publik mbledhin, përpunojnë dhe administrojnë të dhëna personale për përdorim vetëm në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 17

Të drejtat e pronësisë mbi të dhënat

Pronësia mbi informacionin dhe të dhënat e shkëmbyera përmes shërbimeve të qeverisjes elektronike i përket autoritetit publik që ka përgjegjësinë ligjore për të krijuar, ruajtur, administruar këto të dhëna, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Autoriteti publik ka detyrimin për saktësinë e të dhënave në pronësi dhe përditësimin e tyre.

Neni 18

E drejta e komunikimit në formë elektronike për shërbime të qeverisjes elektronike

1. Personat fizik dhe juridik, kanë të drejtë të:
 - a) komunikojnë dhe të ndërveprojnë me autoritetet publike duke përdorur TIK;
 - b) përdorin sistemet e TIK me qëllim përdorimin/marrjen e shërbimeve të qeverisjes elektronike;
 - c) marrin dhe të japin informacion nga autoritetet publike;
 - d) dorëzojnë kërkesa, aplikime, deklarata, dokumente plotësuese në formë elektronike;
 - e) të marrin dokumente elektronike të krijuara nga autoritetet publike;
 - f) të realizojnë pagesa elektronike.
2. Ofrimi i shërbimit publik në mënyrë elektronike, kur ai është i realizuar/zhvilluar ka përparësi dhe ofrohet si alternativa e parë për marrjen e shërbimit publik, nga autoriteti publik që ofron shërbimin direkt ose përmes e-albania.al.
3. Pa anashkaluar pikën 2, personat fizik dhe juridik kanë të drejtë të zgjedhin midis mjeteve dhe mënyrave të vëna në dispozicion për të komunikuar dhe ndërvepruar me autoritetet publike.
4. Zgjedhja e mënyrës së komunikimit apo/dhe ndërveprimit, deklarohet në fillim të komunikimit nga marrësi i shërbimit tek autoriteti publik që është ofrues i shërbimit. Mënyra e komunikimit dhe/ose e ndërveprimit mund të ndryshohet nga ofruesi i shërbimit ose personi fizik/juridik në një moment të mëvonshëm, vetëm pas deklarimit të ndryshimit tek po i njëjti autoritet publik i cili ka pranuar zgjedhjen fillestare.
5. Autoriteti publik në rast të ndryshimit të mënyrës së komunikimit dhe ndërveprimit, nëse kjo imponohet nga nevoja organizative të detyrueshme, lajmëron publikisht dhe jo më vonë se 48 orë nga ndryshimi, për këtë ndryshim të mënyrës së komunikimit apo ndërveprimit.
6. Në realizimin e të drejtave për të marrë shërbime të qeverisjes elektronike personat fizik dhe juridik, njoftohen dhe ndihmohen përmes pikës së kontaktit të autoritetit publik.

KREU IV

AUTORITETET PUBLIKE PËRGJEGJËSE TË QEVERISJES ELEKTRONIKE

Neni 19

Struktura kombëtare e shërbimeve të qeverisjes elektronike

1. Autoritetet kombëtare përgjegjëse për shërbimet e qeverisjes elektronike janë: Ministri përgjegjës, Bordi i Shoqërisë së Informacionit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në vijim AKSHI, dhe autoritetet publike përgjegjëse për ofrimin/realizimin e shërbimit publik dhe/ose administruese të bazave të të dhënave shtetërore.
2. Bordi i shoqërisë së informacionit është organ këshillimor që ushtron veprimtarinë e tij me kohë të pjesshme dhe mbledhet sa herë që është e nevojshme për realizimin e veprimtarisë së përcaktuar sipas këtij ligji.
3. AKSHI është institucioni përgjegjës për infrastrukturën qendrore të shërbimeve të qeverisjes elektronike dhe ofrimin e shërbimeve elektronike të përqëndrura në zbatim të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për shërbimet publike.
4. Institucionet administruese të bazave të të dhënave shtetërore janë autoritetet e parashikuara në ligjin në fuqi “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

Neni 20

Roli i ministrit përgjegjës

Ministri përgjegjës ka këto kompetenca:

1. Harton dhe paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave propozimet për strategjinë dixhitale, politikat e zhvillimit të qeverisjes elektronike dhe shërbimeve publike.
2. Ndjek zbatimin e politikës së Këshillit të Ministrave për qeverisjen elektronike dhe shërbimet publike dhe mbikqyr zbatimin e këtij ligji.
3. Harton dhe paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave projektaktet ligjore e nënligjore, për zhvillimin e qeverisjes elektronike dhe shërbimeve publike elektronike përfshirë standartet/rregullat për projektet TIK në administratën publike.
4. Mund të nxjerrë urdhra dhe udhëzime për çështje që lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe politikave të zhvillimit të qeverisjes elektronike dhe shërbimeve publike.

Neni 21

Bordi i Shoqërisë së Informacionit

1. Bordi është organ këshillimor i Ministrit dhe i Këshillit të Ministrave për zhvillimin e infrastrukturës kombëtare të shoqërisë së informacionit.
2. Përbërja, fusha e veprimtarisë, të ftuarit në mbledhjet e Bordit, si dhe rregullat më të hollësishme për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij bordi përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

Neni 22

Detyrat e AKSHI-t

AKSHI ka këto detyra e përgjegjësi:

1. Zhvillon, administron dhe mirëmban infrastrukturën qendrore të shërbimeve të qeverisjes elektronike e përcaktuar sipas nenit 41 të këtij ligji;
2. Zhvillon, administron dhe mirëmban shërbimet e qeverisjes elektronike të ofruara përmes portalit e-albania.al;
3. Ofron shërbimet e përqendruara online për qytetarët përmes teknologjisë së informacionit e komunikimit (TIK) për qeverisjen elektronike;
4. Ofron shërbimet e përqendruara të TIK-ut për administratën publike, përfshirë shërbimet e autentifikimit dhe nënshkrimit elektronik;
5. Merr pjesë në përcaktimin e standardeve të TIK-ut, që do të ndiqen nga institucionet e administratës shtetërore të cilat miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave;
6. Bashkërendon projektet në fushën e SHI-së, që zbatohen në të gjitha institucionet publike sipas përcaktimeve të këtij ligji;
7. Kontribuon në hartimin e kuadrit ligjor për SHI dhe zbaton politikat e strategjitë për zhvillimin e sektorit të SHI-së;
8. Kontribuon për zhvillimin e shoqërisë së informacionit dhe qeverisjes elektronike në të gjithë sektorët e administratës publike, duke i dhënë përparësi institucioneve që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për publikun dhe bizneset;
9. Për përmbushjen e detyrave të veta funksionale AKSHI përdor burimet njerëzore, për ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike 24 orë në 24 orë për 7 ditë të javës;
10. Ofrimin e certifikimit elektronik dhe shërbimet e besuara sipas legjislacionit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

Neni 23

Detyrat e Autoriteteve Publike në ofrimin e shërbimeve elektronike

1. Çdo autoritet publik përgjegjës për ofrimin/realizimin e shërbimit publik sipas legjislacionit specifik sektorial duhet të respektojë kërkesat e këtij ligji për ofrimin e shërbimeve publike me rrugë elektronike.
2. Çdo autoritet publik përgjegjës për ofrimin/realizimin e shërbimit publik është i detyruar të bashkëpunojë me AKSHI-n për realizimin e shërbimeve të automatizuara sipas këtij ligji përmes platformës qeveritare të ndërveprimit.
3. Çdo autoritet publik është i detyruar të bashkëpunojë me AKSHI-n për ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike përmes portalit qendror e-albania.al.
4. Çdo autoritet publik administrues i bazave të të dhënave shtetërore, zbaton detyrimet e legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore dhe kërkesat e këtij ligji për aq sa ato lidhen me ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike.

KREU V

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT (AKSHI)

Neni 24

Statusi i AKSHI

AKSHI është person juridik publik, i organizuar në formën e agjencisë autonome, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës/kryeministrit.

Neni 25

Organet drejtuese të AKSHI

Organet drejtuese të AKSHI-t janë Këshilli Drejtues dhe drejtori ekzekutiv/i përgjithshëm.

Neni 26

Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues është organi vendimmarrës për çështjet administrative dhe financiare të AKSHI-t.
2. Këshilli Drejtues është organ kolegjal, i përbërë nga pesë anëtarë, nga të cilët:
 - a) nje përfaqësues të caktuar nga kryeministri
 - b) nje përfaqësues të caktuar nga ministri përgjegjës;
 - c) një përfaqësues i caktuar nga ministri që mbulon fushën financiare;
 - ç) një përfaqësues i caktuar nga ministri që mbulon fushën e punëve të brendshme (regjistrin e gjendjes civile);
 - d) një përfaqësues i caktuar nga ministri që mbulon regjistrin e pronave;/ ekonomise;
3. Anëtarët emërohen me urdhër nga ministri i fushës.
4. Kryeministri/Ministri përgjegjës emëron me urdhër njërin prej anëtarëve të Këshillit Drejtues si kryetar të këtij këshilli.

Neni 27

Kompetencat e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues ka këto kompetenca:
 - a) miraton programet e zhvillimit të AKSHI-t, në përputhje me strategjinë/politikat për zhvillimin e qeverisjes elektronike, axhendën dixhitale dhe të dhënat e hapura;

b) propozon strukturën organizative të AKSHI-t dhe nivelin e pagave ministrit përgjegjës/kryeministrit;

c) miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, funksionet dhe përgjegjësitë e drejtorive, të departamenteve, nëpunësve dhe punonjësve të tjerë;

ç) miraton kriteret e propozuara nga drejtori ekzekutiv, që do të zbatohen për punësimin e personelit të AKSHI-t;

d) analizon dhe propozon për miratim të ministri përgjegjës/kryeministrit; programin financiar të AKSHI-t, duke mbikëqyrur dhe kontrolluar periodikisht realizimin e tij;

dh) analizon dhe propozon për miratim të ministri përgjegjës/kryeministrit raportin vjetor të vërtetimit të AKSHI-t

e) i propozon ministrit përgjegjës masën e tarifave që do të zbatohen nga AKSHI-t për shërbimet që kryen, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pasi të jenë marrë mendimi i ministrit që mbulon fushën e shërbimit dhe i ministrit të Financave;

ë) ushtron kompetencat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

f) merr vendime për çështje të tjera, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

2. Nivelet e pagave të AKSHI-t miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon fushën përkatëse të veprimtarisë së këtij institucioni.

3. Struktura e AKSHI-t miratohet nga kryeministri sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 28

Kriteret e emërimit të anëtarëve të Këshillit Drejtues

Për t'u emëruar anëtarë të Këshillit Drejtues, personat duhet të plotësojnë këto kërkesa:

a) të kenë shtetësi shqiptare;

b) të kenë përfunduar studimet e larta universitare të ciklit të dytë të studimeve, "Master i shkencave";

c) të kenë përvojë, të paktën 5 vjet, në administratën publike, ose në fushën e menaxhimit publik e privat, ose të administrimit, në fushën e projekteve TIK ose në institucionet shkencore arsimore;

ç) të jenë me integritet moral dhe profesional;

d) të mos jenë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra penale;

dh) të mos jenë të përjashtuar nga shërbimi civil;

e) të mos kenë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi;

ë) të mos ketë për ta kushte të tjera ndaluese të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 29

Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues

1. Mandati i kryetarit dhe i anëtarëve të Këshillit Drejtues është 4 vjet.

2. Kur mandati i kryetarit ose i anëtarit përfundon, ata qëndrojnë në detyrë deri në çastin e emërimit të kryetarit ose të anëtarit të ri. Një muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtarit të Këshillit Drejtues, AKSHI lajmëron me shkrim ministrin përkatës, i cili fillon praktikën për emërimin e anëtarit të ri.

3. Përjashtimisht për anëtarët e parë të Këshillit Drejtues, zëvendësimi i tyre bëhet në bazë të shortit në këtë mënyrë:

a) 2 anëtarë e përfundojnë mandatin e tyre 2 vit pas kostituimit të këshillit;

b) 2 anëtarë e përfundojnë mandatin e tyre 3 vjet pas kostituimit të këshillit;

c) 1 anëtar e përfundon mandatin e tyre 4 vjet pas kostituimit të këshillit.

4. Në rast se ndonjërit prej anëtarëve të Këshillit Drejtues i përfundon mandati para kohe, anëtari që emërohet qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të paraardhësit të tij.

Neni 30 **Shpërblimet e Këshillit Drejtues**

Kryetari dhe anëtari i Këshillit Drejtues shpërblehen në masën dhe sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 31 **Lirimi dhe pezullimi nga detyra i anëtarit të Këshillit Drejtues**

1. Lirimi nga detyra i anëtarit të Këshillit Drejtues përpara përfundimit të mandatit bëhet kur ai:
 - a) jep dorëheqjen;
 - b) bëhet fizikisht i paaftë për të përmbushur detyrën, për të cilën është emëruar për më shumë se 3 muaj;
 - c) kur mungon pa arsye në më shumë se tri mbledhje radhazi;
 - ç) i shkakton, për shkak të paaftësisë profesionale a të neglizhencës, dëm institucionit ose imazhit të tij;
 - d) vepron gjatë ushtrimit të funksioneve në kundërshtim me interesat e AKSHI-t;
 - dh) dënohet me vendim të formës së prerë për një vepër penale;
 - e) humbet ose lë shtetësinë shqiptare.
2. Nisma për lirimin nga detyra të anëtarit të Këshillit Drejtues mund të ndërmerret nga ministri përgjegjës ose i paraqitet ministrit përgjegjës nga vetë këshilli ose nga institucione të tjera publike, funksioni i të cilave është i lidhur me atë të AKSHI-t.
3. Ministri, në zbatim të pikës 2, të këtij neni, mund të vendosë pezullimin e anëtarit nga funksioni deri në përfundimin e procesit të verifikimit dhe të marrjes së vendimit.
4. Kur ndonjëri prej anëtarëve të Këshillit Drejtues lirohet nga detyra përpara përfundimit të mandatit, anëtari tjetër emërohet sipas së njëjtës procedurë të ndjekur për emërimin e anëtarëve të këtij këshilli.

Neni 32 **Mbledhjet e Këshillit Drejtues**

1. Mbledhjet e këshillit thirren me nismën e kryetarit, me kërkesë të 3 anëtarëve ose me kërkesë të drejtorit ekzekutiv të AKSHI-t. Këshilli Drejtues mblidhet të paktën një herë në dy muaj për të diskutuar e vendosur për rendin e ditës.
2. Mbledhjet e këshillit drejtohen nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve, i autorizuar prej tij.
3. Këshilli në mbledhjen e parë miraton rregulloren për organizimin e punës.
4. Mbledhja e Këshillit Drejtues zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë. Në votim nuk lejohet abstenimi.
5. Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm, ndërsa vendimet e Këshillit nënshkruhen nga kryetari.

Neni 33

Drejtori ekzekutiv

1. Drejtori ekzekutiv është titullari i AKSHI-t, i cili emërohet nga kryeministri me propozim të ministrit përgjegjes.
2. Drejtori ekzekutiv nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Drejtues.
3. Drejtori ekzekutiv merr pjesë në mbledhjet e këshillit, pa të drejtë vote.

Neni 34

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv

Drejtori ekzekutiv ka këto përgjegjësi e detyra:

- a) është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e veprimtarisë së AKSHI-t;
- b) paraqet për miratim në Këshillin Drejtues rregulloren e brendshme të funksionimit të AKSHI-t;
- c) i propozon, sipas legjislacionit në fuqi, Këshillit Drejtues strukturën organizative të AKSHI-t dhe nivelin e pagave për punonjësit;
- ç) paraqet për miratim në Këshillin Drejtues buxhetin dhe programin përkatës të punës përpara fillimit të çdo veprimtarie;
- d) harton dhe paraqet për miratim në Këshillin Drejtues programin ekonomik-financiar të AKSHI-t, si dhe masën e tarifave që do të zbatohen për të gjitha shërbimet që ofron ky institucion;
- dh) ushtron kompetencat në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- e) përcakton dhe paraqet për miratim në Këshillin Drejtues kërkesat për çdo pozicion pune, kriteret e punësimit të personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përparësitë e AKSHI-t dhe me rregulloren e tij të brendshme;
- ë) emëron personelin e nevojshëm, sipas kriterëve të përcaktuara, si dhe administron burimet njerëzore e kualifikimet tyre;
- f) përfaqëson AKSHI-n në marrëdhëniet me të tretët;
- g) ushtron të gjitha detyrat e AKSHI-t, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Neni 35

Kriteret për emërimin e drejtorit ekzekutiv

Kriteret për emërimin e drejtorit ekzekutiv janë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë arsim të lartë;
- c) të ketë përvojë, të paktën 5 vjet, në administratën publike ose në fushën e menaxhimit, të administrimit dhe të jurisprudencës;
- ç) të ketë integritet moral dhe profesional;
- d) të mos jetë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra penale;
- dh) të mos jetë përjashtuar nga shërbimi civil;
- e) të mos ketë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.
- ë) të mos ketë për të raste të tjera penguese të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 36

Lirimi nga detyra i drejtorit ekzekutiv

Ministri përgjegjës/kryeministri vendos lirim nga detyra të drejtorit ekzekutiv, sipas rasteve të përcaktuara në legjislacionin e punës.

Neni 37 **Administrata e AKSHI**

1. Rekrutimi i nëpunësve të AKSHI-t bëhet në bazë të kërkesave dhe përkrahjeve të punës, të përcaktuara në rregulloren e brendshme.
2. Procedurat e rekrutimit duhet të jenë transparente dhe jodiskriminuese, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi për funksionimin e administratës. Marrëdhëniet e punës për nëpunësit e AKSHI-t rregullohen sipas Kodit të Punës.
3. Nuk mund të punësohen në strukturat e AKSHI-t personat:
 - a) e dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë;
 - b) që nuk gëzojnë integritet moral dhe profesional;
 - c) për të cilët është marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil.

Neni 38 **Burimet e të ardhurave dhe buxheti i AKSHI**

1. Burimet e të ardhurave të AKSHI-t janë:
 - a) të ardhurat nga tarifat e shërbimit, sipas përcaktimeve në këtë ligj;
 - b) të ardhura nga Buxheti i Shtetit;
 - c) të ardhura nga projekte, hua ose donacione, të marra në përputhje me legjislacionin që rregullon fushën përkatëse dhe burime të tjera të ligjshme.
2. AKSHI realizon të ardhura nga kryerja e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj dhe nga ofrimi i shërbimeve të tjera, në mbështetje të këtyre funksioneve.
3. Tarifa për shërbimet e ofruara, që lidhen me kryerjen e detyrave funksionale, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës. Masa e tarifave duhet të jetë e tillë që mbulon kostot e shërbimit.
4. Të ardhurat nga tarifat për shërbimet e ofruara mund të përdoren nga AKSHI, nga institucionet që e ofrojnë vetë këtë shërbim ose të ndahen ndërmjet AKSHI-t dhe institucionit përkatës.
5. Masa e ndarjes së të ardhurave të përcaktuara në pikën 4, të këtij neni, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Të gjitha tarifat shpallen dhe bëhen publike në format dhe mënyrat e duhura, sipas legjislacionit për të drejtën e informimit.

Neni 39 **Raportimi nga AKSHI**

1. Në vitin pasardhës, AKSHI, nëpërmjet drejtorit ekzekutiv, i paraqet kryeministrit dhe ministrit përgjegjës:
 - a) raportin vjetor për veprimtaritë e tij;
 - b) raportimet financiare vjetore, përfshirë raportin për realizimin e planit të shpenzimeve dhe të të ardhurave, si dhe pasqyrat financiare, sipas afateve të miratuara nga ministri i Financave për mbylljen e llogarive vjetore të qeverisjes së përgjithshme.
 - c) raportim për shkallen e shfrytëzimit të infrastruktures qendrore;

2. AKSHI i paraqet ministrit përgjegjës, në çdo kohë, me kërkesë të tij, çdo të dhënë tjetër, që vlerësohet e nevojshme për realizimin e objektivave të politikës së zhvillimit të qeverisjes elektronike dhe shërbimeve publike.

Neni 40 **Përdorimi i të ardhurave të veta nga AKSHI**

1. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat për kryerjen e funksioneve, sipas këtij ligji, përdoren nga AKSHI për të mbuluar kostot e shërbimit dhe të funksionimit të AKSHI-t sipas planit të miratuar.
2. Të ardhurat e papërdorura derdhen në Buxhetin e Shtetit. Përjashtim nga ky rregull bëjnë vetëm ato të ardhura, të cilat janë përdorur për kryerjen e një investimi, i cili është në vazhdim dhe gjatë vitit pasardhës buxhetor.
3. Për menaxhimin e të ardhurave të veta, AKSHI krijon llogari rrjedhëse pranë bankave të nivelit të dytë.
4. Të ardhurat që vijnë nga Buxheti i Shtetit përdoren sipas rregullave të përcaktuar në legjislacionin përkatës.

Neni 41 **Auditimi i AKSHI**

Veprimtaria e AKSHI-t auditohet nga autoritetet kompetente të auditimit sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI **INFRASTRUKTURA DHE OFRIMI I SHËRBIMEVE TË QEVERISJES** **ELEKTRONIKE**

Neni 42 **Infrastruktura qendrore e shërbimeve të qeverisjes elektronike**

1. Infrastruktura qendrore e shërbimeve të qeverisjes elektronike synon ndëveprimin/interoperabilitetin e regjistrave publik dhe të sistemeve të informacionit publik si dhe ofrimin e shërbimeve për persona juridikë publik si dhe midis autoriteteve publike.
2. Për administrimin, menaxhimin dhe infrastrukturës së shërbimeve të qeverisjes elektronike ngarkohet AKSHI.
3. Infrastruktura qendrore e shërbimeve të qeverisjes elektronike përfshin:
 - a) Portalin unik qeveritar e-albania, platformën qeveritare të ndëveprimimit për ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike, sipas tipologjisë: qeveri-qeveri, qeveri – qytetar, qeveri – biznes;
 - b) Regjistrin kombëtar të shërbimeve elektronike qeveritare sipas modeleve të miratuara për shërbimet publike;
 - c) Regjistrin kombëtar të bazave të të dhënave shtetërore;
 - d) Qendrën e të dhënave qeveritare (Datacenter-in Qeveritar);
 - e) Qendrën e rivendosjes dhe/ose vazhdueshmërisë së punës së Datacenter-it Qeveritar, në rast fatkeqësie (Disaster Recovery Center);

- f) Qendrën e vazhdueshmërisë së punës ("Business Continuity Center", BCC) dhe qendrën e ruajtjes së informacionit (Back-up Center), me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimeve pa ndërprerje 24 orë në 24 orë për 7 ditë të javës;
 - g) Rrjetin qeveritar (Govnet);
 - h) Çelësin publik dhe menaxhimin e certifikatave digjitale për administratën shtetërore;
 - i) Sistemin e administrimit të dokumentit elektronik, përfshirë protokollin dhe arkivin elektronik;
 - j) Platformën qeveritare të pagesave elektronike.
4. Rregullat për funksionimin dhe sigurinë e infrastrukturës qendrore të shërbimeve të qeverisjes elektronike miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
 5. Për sigurinë e informacionit dhe sistemeve kur ato janë të klasifikuara, zbatohen detyrimet sipas legjislacionit për informacionin e klasifikuar.

Neni 43

Ofrimi i automatizuar i shërbimeve të qeverisjes elektronike

Ofrimi i automatizuar i shërbimeve të qeverisjes elektronike realizohet në formë elektronike nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit, duke u bazuar në identifikimin dhe autentifikimin e kërkuesve sipas rregullave të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 44

Portali unik qeveritar

1. Shërbimet e qeverisjes elektronike për personat fizikë dhe juridikë dhe autoritetet publike ofrohen nëpërmjet, portalit unik qeveritar www.e-albania.al dhe/ose nga ofruesi i drejtpërdrejtë i shërbimit.
2. Shërbimet e qeverisjes elektronike regjistrohen në regjistrin kombëtar të shërbimeve elektronike pranë AKSHI-t.
3. Autoritetet publike garantojnë saktësinë, vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e informacioneve që postojnë apo njoftojnë për postim në portalin unik qeveritar. Autoritetet publike janë përgjegjëse për përditësimin e informacioneve dhe shërbimeve që ofrojnë sipas rregullave të miratuara për shërbimet publike.
4. Aksesit, ruajtja, trajtimi dhe përpunimi i të dhënave në portalin unik qeveritar bëhet në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën për informim.
5. Portali unik qeveritar ofron mundësinë e kryerjes së pagesës elektronike sipas legjislacionit në fuqi për ato shërbime që ofrohen kundrejt pagesës.

Neni 45

Qendra e të dhënave qeveritare

1. Qendra e të dhënave qeveritare është njësi qendrore e të dhënave qeveritare që realizon shkëmbimin dhe koordinimin e bazave të të dhënave shtetërore në përputhje me legjislacionin për bazat e të dhënave shtetërore.
2. Rregullat e funksionimit dhe organizimit të qendrës së të dhënave qeveritare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 46

Ofrimi i dokumentave vetëm një herë

1. Autoriteti publik, për aq sa është e mundur teknikisht, duhet të sigurojë që individi ose personat fizik e juridik, marrës të shërbimeve publike dhe/ose dokumentave administrative paraqesin të njëjtin informacion, vetëm njëherë në institucionet e administratës publike.
2. Kur komunikimet midis sistemeve realizohet me anë të ndërveprimit, dhe kur ripërdorimi i të dhënave është i lejuar, autoriteti publik, ndërmerr veprimin për sigurimin e të dhënave nga autoriteti publik ku janë paraqitur më parë nga aplikuesi, duke mos krijuar pengesa për marrësin e shërbimit dhe respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Dokumentat e gjeneruara nga një autoritet publik nuk është e nevojshme të paraqiten nga marrësi/kërkuesi i shërbimit, ato tërhiqen/merren nga autoriteti publik përgjegjës për realizimin e shërbimit direkt nga autoriteti publik që e ka gjeneruar dokumentin zyrtar. Rregulla të detajuara për zbatimin e parimit vetëm njëherë miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
4. AKSHI publikon dhe perditëson çdo tre muaj listen e dokumentave që gjenerohen elektronikisht përmes sistemit të përqendruar të shërbimeve publike.

Neni 47 Burimet e hapura

Zbatimi i parimit burime të hapura, nga autoritetet publike në zhvillimin e sistemeve dhe shërbimeve elektronike për aq sa është e mundur teknikisht dhe e justifikuar në lidhje me kostot dhe sigurinë, bëhet sipas rregullave të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave .

KREU VII OFRIMI DHE PËRFITIMI I SHËRBIMEVE ELEKTRONIKE PUBLIKE DHE DOKUMENTAVE ADMINISTRATIVE NË RRUGE ELEKTRONIKE

Neni 48 Ofrimi i shërbimeve elektronike informative

Ofrimi i shërbimeve elektronike informative është i hapur për çdo përdorues. Ai ofrohet pa pasur nevojë për regjistrim dhe identifikim të marrësit të shërbimit.

Neni 49 Përfitimi i shërbimit elektronik publik me regjistrim dhe identifikim

1. Ofrimi i shërbimeve të qeverisjes elektronike jo informative apo aplikimi për marrjen e një dokumenti administrativ, bëhet vetëm pasi kryhet regjistrimi dhe autentifikimi i përdoruesit. Origjinaliteti i kërkesës vërtetohet në mënyrë elektronike në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.
2. Aplikimi i kryer përmes platformës qeveritare të ndërveprimit, pas verifikimit i përcillet elektronikisht përmes ESB-së, institucionit/eve përgjegjëse për shqyrtimin e aplikimit dhe dhënien e shërbimit elektronik apo për lëshimin e dokumentit administrativ. Dhënia e shërbimit kryhet sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe legjislacionit specifik që rregullon shërbimin e kërkuar.

3. Përpara procesit të regjistrimit, personat informohen për qëllimet e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale në kuadër të ofrimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike.
4. Përveç sa përcaktohet në pikat e mësipërme të këtij neni, mënyra e detajuar e identifikimit, autentifikimit, vërtetimit dhe regjistrimit në portalin unik qeveritar si dhe specifikimet teknike të ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore për regjistrimin dhe autentifikimin përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 50

Krijimi i shërbimeve elektronike dhe komunikimi i sistemeve

1. Komunikimi i të dhënave të kërkuara, kryhet nëpërmjet sistemit të ndërveprimit (ESB), në mënyrë të sigurtë sipas legjislacionit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara dhe rregullave të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Krijimi dhe ofrimi i shërbimeve të qeverisjes elektronike që ofrohen përmes portalit unik qeveritar, bëhet në bashkëpunim me institucionet e tjera të administratës shtetërore në fushën e shërbimeve publike përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve respektive.
3. Për realizimin e shërbimeve të përqendruara përmes portalit unik dhe komunikimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të ndërveprimit, autoritetet publike lidhin marrëveshje bashkëpunimi me AKSHI.

Neni 51

Përmbajtja e dokumenteve administrative

Dokumentet administrative elektronike duhet të përmbajnë të paktën:

- a) Të dhënat e kërkuara prej aplikuesit, të cilat përfitohen nga transmetimi elektronik, nga sistemi që disponon bazën e të dhënave;
- b) Vulën elektronike të gjeneruar nga një certifikatë e kualifikuar, të institucionit lëshues (AKSHI);
- c) Formën vizuale të vulës elektronike, të përcaktuar sipas nenit xx të këtij ligji;
- d) Shënimin në fund të faqes “ky dokument është lëshuar nga sistemi elektronik me procedurë automatike dhe garantohet nga transmetimi elektronik dhe vula elektronike”.

Neni 52

Vlefshmëria ligjore

1. Dokumentet administrative që përfitohen nga bazat e të dhënave shtetërore përmes transmetimit elektronik të të dhënave, me nënshkrim elektronik ose vulë elektronike, kanë të njëjtën vlerë ligjore dhe fuqi provuese si çdo dokument tjetër zyrtar.
2. Autoriteti publik dhe personat fizike e juridik nuk kanë të drejtë të refuzojnë një dokument administrativ të gjeneruar në rrugë elektronike nga autoritetet publike apo ESB.
3. Dërgimi dhe pranimi i të dhënave kryhet në përputhje me ligjin për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Forma e vulës elektronike të dokumentit administrativ, dhe rregullat për vulosjen automatike miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Nëpunësi i autorizuar i autoritetit publik akseson dhe konfirmon dokumentin elektronik ose administrativ sipas rregullave të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave .

Neni 53

Faqet zyrtare të internetit të autoriteteve publike

1. Autoritetet publike kanë detyrimin të krijojnë dhe mirëmbajnë faqen e tyre zyrtare në internet, lehtësisht të aksesueshme për ofrimin e informacionit në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin për të drejtën e informimit. Ky detyrim përmbushet edhe në rastet e hostimit të faqes zyrtare së internetit të institucioneve të varësisë.
2. Autoritetet publike garantojnë saktësinë, vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e informacioneve që postojnë apo njoftojnë për postim në portalin unik qeveritar. Autoritetet publike janë përgjegjëse për përditësimin e informacioneve dhe shërbimeve që ofrojnë. Në çdo rast informacioni i publikuar mban datën e përditësimit më të fundit të saj.
3. Përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe, faqet zyrtare të institucioneve publike, janë faqe të lira dhe pa kufizime në akses.
4. Rregullat e krijimit dhe ruajtjes së faqes zyrtare të internetit nga autoritetet publike, kushtet e veçanta, politikat e sigurisë dhe çdo detaj tjetër i nevojshëm për administrimin e tyre, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës.

Neni 54

Shkëmbimi dhe qarkullimi i dokumentit elektronik për administratën shtetërore

1. Shkëmbimi dhe qarkullimi i dokumentit elektronik ndërmjet institucioneve të administratës publike në nivel qendror kryhet nëpërmjet postës elektronike qeveritare dhe sistemit të administrimit të dokumentit elektronik.
2. Rregullat për përdorimin e postës elektronike qeveritare dhe rregullat për përdorimin e sistemit të administrimit elektronik të dokumentit në administratën publike në nivel qendror, përfshirë protokollin dhe arkivin elektronik, miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 55

Pagesa elektronike

1. Për marrjen e shërbimeve publike elektronike ofrohet mundësia e pageses elektronike në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ai që ka detyrimin sipas kushteve të identifikimit të tij, nëpërmjet portalit unik qeveritar.
2. Pagesat elektronike kryhen sipas rregullave të miratuara në legjislacionin në fuqi për instrumentat e pagesave.
3. Ministri i Financave përcaktohen taksat, tarifat, dhe gjobat që mund të paguheshin dhe mbledhen elektronikisht.

KAPITULLI VIII

ZHVILLIMI DHE SUPERVIZIMI I PROJEKTEVE TIK

Neni 56

Zhvillimi i projekteve TIK për administratën publike

Përveç sa parashikon legjislacioni për prokurimet publike, projektet TIK në administratën publike duhet të zhvillohen dhe projektohen në mënyrë që të garantojnë ndërveprueshmërinë e sistemeve dhe shërbimeve në përputhje me rregullat e miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave sipas këtij ligji.

Standardet e projektimit të sistemeve TIK në administratën publike dhe cmimet referuese miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 57

Vazhdueshmëria e Punës dhe ruajtja e informacionit (BCC)

1. Çdo autoritet publik që ofron ose synon të ofrojë shërbime të qeverisjes elektronike për personat fizikë dhe juridikë ose të ndërveprojë dhe shkëmbejë informacion me autoritete të tjera publike në hartimin dhe zhvillimin e projekteve TIK duhet të parashikojë dhe realizojë krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës dhe sistemin e ruajtjes së informacionit, me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes dhe shkatërrimit aksidental të të dhënave.
2. Kriteret për garantimin e sigurisë, marrjen e masave dhe hartimin e planeve të shpëtimit, identifikimin e llojit të të dhënave dhe pajisjeve të rëndësishme për sistemet përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 58

Marrëveshjet e nivelit të shërbimit (SLA)

1. Çdo autoritet publik që ofron ose synon të ofrojë shërbime të qeverisjes elektronike për personat fizikë dhe juridikë ose të ndërveprojë dhe shkëmbejë informacion me autoritete të tjera publike duhet të parashikojë dhe hartojë një marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit. (Service Level Agreement)
2. Me udhëzim të ministrit përgjegjës përcaktohen elementet që duhet të përmbajë SLA për projektet TIK.

Neni 59

Supervizimi i projekteve TIK

1. Me qëllim garantimin e mirëfunksionimit të projekteve TIK që lidhen me ndërveprimin e sistemeve dhe projektet në përfitim në më shumë se një institucioni, me kërkesë të secilës palë përfituese, si dhe në rastet e justifikuara të projekteve madhore, me ndikim në zhvillimin/zbatimin e politikave për e-qeverisjen, ministri përgjegjës inicion ngritjen e një grupi për supervizimin e implementimit të projektit TIK.
2. Supervizimi sipas pikës 1, bëhet nga ekspertë /supervizor të certifikuar me certifikata të njohura nderkombetare respektive, apo të licencuar sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe/ose nga ekspertë të institucioneve të përfshira në projekt.
3. Ministri miraton/publikon listën e certifikatave të njohura, të aplikuara për projektet respektive TIK.

KREU IX

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 60

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin në ofrimin e shërbimeve elektronike sipas këtij ligji midis autoriteteve publike zgjidhen me mirëkuptim sipas klauzolave të përcaktuara në marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur midis tyre bazuar në Kodin e Procedurës Administrative.
2. Mosmarrëveshjet midis marrësit të shërbimit dhe autoritetit publik, ofrues i shërbimit zgjidhen fillimisht nga autoriteti publik ofrues i shërbimit, dhe në rast mosdakortësie marrësi i shërbimit i drejtohet gjykatës.

Neni 61

Ankimi Administrativ

1. Personat që nuk kanë marrë shërbimin e kërkuar të qeverisjes elektronike kanë të drejtë që të paraqesin, brenda 5 ditëve, nga dita që kanë marrë përgjigjen apo që duhet ta kishin marrë, një ankesë në portalin elektronik.
2. Autoriteti përgjegjës për mirëmbajtjen dhe funksionimin e portalit elektronik krijon dhe mirëmban, një rubrikë për ankimet për shërbimet e ofruara nëpërmjet portalit elektronik.
3. Ankimin në momentin e paraqitjes vlerësohet nëse është bërë për mënyrën e funksionimit të portalit elektronik, apo për shërbimin publik të kërkuar. Në rast se ankimi është bërë për mënyrën e funksionimit të portalit elektronik, atëherë autoriteti përgjegjës detyrohet që të kthejë një përgjigje brenda 5 ditëve punë.
4. Në rast se ankimi është bërë për shërbimin e kërkuar, atëherë autoriteti përgjegjës ia komunikon në rrugë elektronike strukturave përkatëse të institucionit përgjegjës për ofrimin e shërbimit, i cili përgjigjet brenda 10 ditëve punë nëse legjislacioni i posaçëm nuk parashikon afate të ndryshme. Në çdo rast, ankuesi njoftohet se cili institucion është duke shqyrtuar ankimin e tij.

Neni 62

Ankimi në gjykatë

Në rastet kur ankuesi nuk është dakord me përgjigjen e marrë ose kur nuk ka marrë përgjigje brenda afateve të përcaktuara ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 63

Masat administrative

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë:
 - a) Me gjobë në vlerën ____ lekë për rastet kur shkel nenin 15 të këtij ligji;
 - b) Me gjobë në vlerën ____ lekë për rastet kur shkel nenin 17 të këtij ligji;
 - c) Me gjobë në vlerën ____ lekë për rastet kur shkel piken 5 të nenit 18 të këtij ligji;
 - d) Me gjobë në vlerën ____ lekë për rastet kur shkel nenin 46 të këtij ligji;
 - e) Me gjobë në vlerën ____ lekë për rastet kur shkel nenin 50 të këtij ligji;
 - f) Me gjobë në vlerën ____ lekë për rastet kur shkel nenin 50 të këtij ligji;
 - g) Me gjobë në vlerën ____ lekë për cdo shkelje tjetër të detyrimeve sipas këtij ligji;
2. Në vendosjen e gjobave, sipas këtij neni, do të merret parasysh:
 - a) faktimi i shkeljes;
 - b) rëndësia dhe kohëzgjatja e kundërvajtjes;
 - c) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;
 - ç) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;
 - d) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.

4. Gjopa është titull ekzekutiv, që vendoset nga Autoriteti Përgjegjës, i cili mbikëqyr veprimtarinë e subjektit që kryen shkeljen. Si rregull, për të njëjtën shkelje administrative, nuk mund të aplikohet më shumë se një gjopë. Gjopat duhet të jenë efektive, proporcionale dhe të arsyetuara. Gjopa mblidhet nga autoriteti që e vendos atë dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit.
5. Procedura e konstatimit, vendosjes dhe ekzekutimit të gjopave, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU X DISPOZITA TE FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 64 Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e tij.
2. Ngarkohet ministri për nxjerrjen e udhëzimeve në zbatim të këtij ligji brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 65 Dispozitë kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) krijuar me Vendimin Nr. 703, datë 28.10.2014 “Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, vazhdon funksionimin dhe riorganizohet në përputhje me këtë ligj brenda tri muajve me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
2. Punonjësit dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKSHI-t të emëruar sipas VKM 703 dt. 28.10.2014 vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 66 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

ILIR META